REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK/DMP 03-1793/2012
Nr. i faq Broj stranica 02 Nr. pages
Regj.Nr. 428/12 18.05.2012
PRISHTINË

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, përmes gjyqtares Luljete Shabani me Sekretaren .Juridike Hamide Zeqir , duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit Qemajl Mustafa nga fsh.Malishevë për shkak të kundërvajtjes nga neni 8, paragrafi 1 ,neni 18.paragrafi 4,8 dhe 12 të Ligjit nr.04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e në bazë të nenit 73,195 të Ligjit mbi kundërvajtjet me datë 14.05.2012, mori këtë

A K T V E N D I M

.I pandehuri Qemajl Fehmi Mustafa, i lindur më 38.04.1960, në fsh.Malishevë, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Kosovës, Kryetar i Komunës së Gjilanit, i martuar, baba i dy fëmijëve, me gjendje të mesme ekonomike ,

Ë SH T Ë P Ë RG J E GJ Ë S

. Sepse, më datë 23.12.2012, nga Agjencia Kundër Korrupcionit, është vërtetuar se ekziston Konflikti i Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,Kryetar Komune, meqë ai , si njëri prej pronarëve të biznesit privat , SH.P.K. "Frutta Viva", ka qenë personi i vetëm i autorizuar i atij biznesi,

me çka ka bërë vepër kundërvajtëse nga neni 8, paragarfi 1 të Ligjit nr..04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, andaj,

D Ë NO H E T

ME DËNIM GJOBE në shumë prej 700 (shtatëqind) €, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën dënimi i paraparë me burg do të zëvëndësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, që do të thotë, një ditë burgu, 15 €

Obligohet i pndehuri që në afat të njëjtë si edhe dënimin, t'i paguajë kësaj Gjykate shumën prej 10 (dhjetë) €,në bazë të nenit 109 të LMK

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë,, me kërkesën nr. 03-3142/11, të dt.23.12.2011, ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zhvillohet procedura kundërvajtëse.

Gjykatësja shqyrtoi kërkesën e bërë dhe gjeti se e njejta është e bazuar në Lijg.

I pandehuri, në këtë gjykatë pjesërisht e pranoi veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë, duke thenë se vërtetë ai gjer më dt. 01.02.2012, formalisht ka qenë person i autorizuar i biznesit privat "Frutta Viva", por, u arsyetua se kjo ka ndodhur pa fajin e tij, në pamundësi që të nënshkruajnë dy nga themeluesit e këtij biznesi, për shkak të qëndrimit të tyre jashtë vendit, gjë për të cilën, ai e ka njoftuar edhe AKK-në, poe, mendon se AKK-ja është marrë vetëm me aspektin formalo-juridik, pa e dëgjuar argumentimin e tij për qarkullimin e këtij biznesi, i cili që nga themelimi në vitin 2006, nuk ka pasur fare qarkullim.Ai shtoi se AKK-ja ka lejuar që ky moment të keqpërdoret nga mediat dhe dhe nga një pjesë e spektrit politik, për t'a dëmtuar imazhin e tij si kryetar Komune, ndërsa, sa i përket faktit se gjoja ai nuk i është përgjrigjur thirrjes së AKK-së për sqarimtë situates,ai deklaroi se nuk është e vërtyetë, meqë ky herën e parë ka qenë në AKK, ndërsa, herën e dytë, ka kontaktuar me telefon.

Përfaqësuesi i AKK-së, Frashër Murtezaj, deklaroi se AKK qëndron pranë kërkesës për fillimn e procedurës kundërvajtëse ndaj z. Qemajl Mustafa, për veprën kundërvajtëse të kualifikuar, si Konflikt Interesi të kryer gjatën ushtrimit të funksionit Publik.

Ai tha se AKK, së pari i ka bërë shkresën e pare njoftuese zyrtare z. Qemajl Mustafa,me të cilën e ka informuar se kanë filluar hetimet për gjendjen e Konfliktit të Interesit, me ç'rast, i është dhënë mundësia që brenda afatit prej 15 ditësh të ballafaqohet me faktet .Në takimn e zyrtarëve të AKK-së me z. Qemajl, e kanë njoftuar ate me faktet që posedon AKK rreth ekzistimit të konfliktit të interesit dhe ka në kërkuar nga ai që në afatin ligjor t'i bëjë ndryshimet e nevojshme për shmangjen e atij konflikti dhe për pasojat që mund t'i ketë,por, edhe pas kalimit të afatit, ai nuk i është përgjigjur kërkesës së AKK-së ndërsa,pas komunikimit me telefon, meqë ai përsëri nuk ka bërë veprimet e nevojshme, AKK, ka bërë shkresën e dytë , por, ai edhe pas kësaj shkrese nuk është përgjegjur,për çka, AKK, duke respektuar procedurat ligjore,është detyruar të bëjë Kërkesë për fillimin e procedures Kundërvajtëse ndaj tij.